



VENDIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 11 nëntor 2015

Nr. i lëndës 2011-20

X dhe 115 ankues të tjerë

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 11 nëntor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 22 PRILL 2015

1. Më 22 prill 2015, Paneli ka lëshuar vendimin e tij në lidhje me ankesën e parashtruar nga X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it dhe bëri një numër rekomandimesh për Shefin e Misionit (ShM) në pajtim me Rregullën 34 të Rregullores së Punës. Vendimi thotë:

"PANELI NJËZËRI,

1. *Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës së [të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore];*
2. *Konstaton se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 6 të Konventës.*
3. *Gjen të përshtatshme, në dritën e gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit, të bëjë rekomandimet e mëposhtme për Shefin e Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së punës:*
 - i. ShM-ja duhet të udhëzoj zyrtarët kompetent të EULEX-it të hetojnë me autoritetet e Kosovës nëse hetimi në këtë çështje është në vazhdim dhe, nëse po, në cilën fazë të procesit qëndron çështja. ShM-ja duhet të informojë Panelin për rezultatin e këtij hetimi.
 - ii. Pas pranimit të atij informacioni, ShM-ja duhet të udhëzoj prokurorët e EULEX-it të shqyrtojnë nëse duhet marrë përsipër përgjegjësinë e këtij rasti sipas nenit 7 (A) të Ligjit Nr.04 / L-273, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante, siç është theksuar më lartë, në veçanti nevojën e Misionit për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të ankuesve. ShM-ja duhet të informojë Panelin për vendimin e Prokurorit në këtë drejtim.

Paneli kërkon nga ShM-ja që t'i ofroj Panelit informacionin e kërkuar jo më vonë se më 15 qershor 2015."

2. Paneli përkujton se Zyra e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë ka regjistruar një ankesë në lidhje me kryerjen e një veprë penale, të parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve, më 21 nëntor 2013. Fillimisht, EULEX-i ka caktuar një prokuror për t'u marrë me të; pastaj rasti i është caktuar një ekipi të përzier të prokurorëve të EULEX-it dhe të Kosovës. Më 30 maj 2014, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhet me mandatin e Misionit për Sundimin e Ligjit të Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës ka hyrë në fuqi me efekt retroaktiv nga data 15 prill 2014. Në bazë të Nenit 1. A (1) prokurorët e EULEX-it kanë autoritetin për të kryer hetime penale në parim vetëm në rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është lëshuar para datës 15 prill të vitit 2014. Në rastin konkret hetimi është iniciuar pikërisht me 15 prill 2014. Për këtë arsye rasti nuk mund të konsiderohej si një rast i vazhdueshëm brenda kuptimit të kësaj dispozite dhe hetimet nuk mund të kryheshin nga prokurorët e EULEX-it. Si pasojë, hetimi është marrë përsipër nga prokurorët Kosovar të Zyrës Themelore të Prokurorëve në Mitrovicë.
3. Vendimi i tanishëm përbën një vazhdim të vendimit të Panelit të datës 22 prill 2015 dhe rekomandimeve të bëra aty. Kompetenca dhe autoriteti i Panelit për të lëshuar vendime pasuese në vendimet dhe rekomandimet e tij është dhënë në rregullën 45 bis të Rregullores së Punës së Panelit (shih p.sh. vendimet mbi zbatimin e rekomandimeve [W kundër EULEX-it](#), 2011-07, 26 gusht 2014, [H & G kundër EULEX-it](#), 2012-19 & 20, 27 maj 2014).

II. INFORMACIONI I PRANUAR NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

4. Më 31 gusht 2015, ShM-ja ka njoftuar Panelin lidhur me një numër masash që ai kishte ndërmarrë në lidhje me rekomandimet e Panelit.
5. Në veçanti, ai i shkroi Ushtruesit të Detyrës së Kryesuesit të Divizionit Ekzekutiv të EULEX-it dhe Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it duke u kërkuar atyre që të marrin në konsideratë vendimin e Panelit dhe të vlerësojnë nëse do të ketë një mundësi që të zbatohet neni 7A të Ligjit nr. 04 / L-273 mbi juridiksionin dhe kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it siç është amendamentuar (Ligji mbi kompetencat) në rastin penal që ishte subjekt i vendimit të Panelit dhe t'i caktojë çështjen një Prokurori të EULEX-it për shkak të "rrethanave të jashtëzakonshme" brenda kuptimit të kësaj dispozite.
6. Më 19 gusht 2015, Ushtruesi i Detyrës së Kryesuesit dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit informuan ShM-në që, se siç kërkohet me nenin 7A, mundësia për të marrë rastin përsipër nga prokurorët e EULEX është vlerësuar bashkërisht nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës dhe Kryeprokurori i EULEX-it. Mirëpo, ata arritën në përfundim se "rrethanat e jashtëzakonshme", siç kërkohet nga neni 7A nuk janë përmbushur kështu që kompetenca ligjore e prokurorëve të EULEX-it nuk mund të iniciohej. Megjithatë, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it siguroj ShM-në se, nëse dalin rrethana të tilla në të ardhmen, rasti dhe zbatueshmëria e nenit 7A mund të rishqyrtohet.
7. Më tej, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it ka pohuar se në vendimin e tij mbi meritat e rastit aktual Paneli kishte kritikuar EULEX-in për fillimin e hetimit një ditë pas të ashtuquajturës "afatit të fundit" të datës 14 prillit 2014. Ai argumentoj se deri tani nuk ka pasur ndonjë vendim për fillimin e hetimeve, por rasti aktualisht ka mbetur në fazën fillestare të hetimit me qëllim që të përcaktohet nëse është kryer ndonjë vepër penale dhe nëse po kush do të jetë i dyshuari i asaj veprë.
8. Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it gjithashtu pohoj se përfaqësuesi i ankuesve nuk i ishte përgjigjur pyetjeve të dërguara nga prokurori vendor dhe informacioni i dhënë nga ankuesit doli të ketë vlerë shumë të kufizuar dëshmuese.
9. Pavarësisht nga çfarë u tha më sipër, prokurori vendor të cilit i është caktuar rasti ka dërguar kallëzimin penal në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës që të vlerësoj nëse i njëjti bie nën kompetencat e tyre. Përgjigja ishte negative; sipas Zëvendës Kryeprokurorit të Zyrës së Prokurorisë Speciale, nuk kishte asnjë tregues të përfshirjes së krimit të organizuar në këtë rast dhe në këtë mënyrë rasti ishte jashtë juridiksionit të saj. Si pasojë, rasti aktualisht mbetet tek autoritetet e ndjekjes penale të Kosovës.
10. Ushtrues i Detyrës së Kryeprokurorit të EULEX-it siguroj se Prokurori i EULEX-it, i cili ishte i caktuar më parë në këtë rast do të jetë në dispozicion të

prokurorit vendor në kapacitetin e tij mentorues dhe këshillues. Për më tepër, një ankesë e hollësishme nga secila palë mund të adresohet në çdo kohë te Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës dhe Kryeprokurori i EULEX-it në qoftë se mendojnë se rrethanat kanë ndryshuar dhe kushtet e përcaktuara në nenin 7 A të Ligjit mbi Juridiksionin janë përmbushur.

III. INFORMATAT NGA ANKUESIT

11. Më 13 shtator 2015, ankuesit parashtuan përgjigjen e tyre rreth informatave të pranuar nga ShM-ja.
12. Ata nuk u pajtuan me vlerësimin e ShM-së se rasti është jashtë juridiksionit të EULEX-it.
13. Ata gjithashtu pohuan, në kundërshtim me pohimet e ShM-së, se përfaqësuesit e tyre asnjëherë nuk ishin kontaktuar nga EULEX-i.
14. Sipas mendimit të tyre, hetimi nuk i ka përmbushur standardet evropiane sa i përket kujdesit të duhur gjatë hetimit të rastit.

IV. VLERËSIMI NGA PANELI

15. Paneli merr parasysh hapat e ndërmarrur nga ShM-ja në zbatimin e rekomandimeve të Panelit.
16. Paneli është i bindur se ShM-ja i ka zbatuar rekomandimet e tij për të hetuar me autoritetet vendore nëse hetimi në këtë rast ishte në vazhdim e sipër. Vihet re në këtë kontekst se çështja fillimisht ishte sjellë në vëmendjen e autoriteteve të Prokurorisë së Kosovës pothuajse dy vite më parë, në nëntor të vitit 2013. Asnjë informacion nuk i është ofruar Panelit nga Shefi i Misionit për të parë nëse kishte ndonjë dëshmi e marrë gjatë hetimit të kryer nga autoritetet e ndjekjes penale të Kosovës, duke përfshirë edhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Po ashtu, nuk është dhënë asnjë informacion lidhur me afatin e mundshëm brenda të cilit rasti mund të përfundojë. E as nuk është vërtetuar nëse viktimat ishin plotësisht të përfshira në procesin hetimor. Prandaj nuk është treguar sa i përket se Paneli nuk është i bindur me atë se ka pasur progres të vërtetë në hetim. Në këto rrethana, e drejta e ankuesit për një mjet ligjor efektive në pajtim me nenin 13 të Konventës ende duket të jetë e ndikuar nga mungesa e evidente e një përpjekjeje që në mënyrë të shpejt dhe efektive të hetohet ky rast.
17. Për më tepër, Paneli vë në dukje vendimin e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Kryeprokurorit të EULEX-it të mos i caktojë çështjen një prokurori të EULEX-it. Paneli konsideron se efikasiteti i hetimit do të ishte rritur shumë në qoftë se do të ishte shfrytëzuar ekspertiza dhe burimet e

EULEX-it.

18. Duke pasur parasysh atë që u tha më sipër, Paneli konsideron se hapat e ndërmarrë deri më tani nga Misioni nuk kanë qenë të tilla që të sigurojnë që e drejta e ankuesve për një mjet efektiv të jetë e mbrojtur në mënyrë efektive. Përderisa Paneli nuk ka nevojë që të vendosë për çështjen në këtë pikë, ai vë në dukje se dështimi i dukshëm i autoriteteve të Kosovës për të hetuar me zell dhe në mënyrë efektive çështjen mund të konsiderohet si "rrethanë e jashtëzakonshme" (neni 7A), duke synuar nenin 13 të Konventës e cila mund të justifikoj Misionin duke marrë përgjegjësinë mbi këtë rast.
19. Paneli fton Misionin për të vazhduar kontaktet me autoritetet kompetente të Kosovës, me qëllim të përcjelljes së progresit në këtë rast.
20. Paneli më tej fton shefin e Misionit të jap informacione mbi mënyrën në të cilën është interpretuar në praktikë nocioni i "rrethanave të jashtëzakonshme" brenda kuptimit të nenit 7A si kriter vendimtar për marrjen përsipër të rasteve nga autoritetet e ndjekjes penale të EULEX-i.
21. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë nga ShM-ja në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

PANELI NJËZËRI

Deklaron se ShM-ja ka zbatuar në pjesë të rekomandimeve të Panelit.

Deklaron se e drejta e ankuesve për një mjet efektiv mbetet e ndikuar nga mungesa e një hetimi efektiv në këtë rast.

Fton ShM-në që të ofroj sqarimin e kërkuar në lidhje me interpretimin e "rrethanave të jashtëzakonshme" në bazë të nenit 7A të Ligjit mbi Kompetencat e Misionit.

Fton Misionin - përmes ShM-së - që të kërkoj azhurnime të rregullta nga autoritetet e Kosovës lidhur me progresin e hetimit të tyre.

Fton ShM-në që të njoftoj Panelin lidhur me progresin e hetimeve jo më vonë se më 28 shkurt 2016.

Vendos që ta mbaj rastin.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese